

VENDIM
Nr. 856, datë 17.12.2004

PËR FINANCIMIN E BORDEVE TË KULLIMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 59 të ligjit nr.8518, datë 30.7.1999 “Për ujitjen e kullimin”, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë dhe të Ushqimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit të përfitojë subvencion nga Buxheti i Shtetit për financimin e veprimtarisë së bordeve të kullimit për sektorët e kullimit, të mbrojtjes nga përmytja dhe të ujitjes.

2. Subvencioni të jepet në përputhje me programin financiar, të miratuar nga Ministri i Bujqësisë dhe i Ushqimit, që bordet e kullimit paraqesin në drejtoritë përkatëse të Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit.

3. Buxheti i Shtetit të financojë për përmirësimin e sistemit ekzistues edhe investimet e kullimit, të mbrojtjes nga përmytja dhe të ujitjes.

4. Rregullat e dhënies së subvencionit për bordet e kullimit dhe qëllimi i përdorimit të tij caktohen me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Bujqësisë dhe të Ushqimit dhe të Ministrit të Financave.

5. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano